



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGjisë

Nr. 968 Prot.

Tiranë, më 03.04 2018

VENDIM Nr. 84, datë 20.03.2018

Në mbëshjetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.4. datë 20.03.2018, pasi shqyrtoi **Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Foinike-Butrint" 2018**, miratuar nga këshilli shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike) drejtues prof. dr. Shpresa Gjongecaj (Instituti Arkeologjisë), prof. dr. Sandro de Maria (Universiteti i Bolonias, Itali), paraqitur nga Institut Arkeologjisë.

VENDOSI:

1. Të miratojë **Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Foinike-Butrint" 2018**, miratuar nga këshilli shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike) drejtues prof. dr. Shpresa Gjongecaj (Instituti Arkeologjisë), prof. dr. Sandro de Maria (Universiteti i Bolonias, Itali), paraqitur nga Institut Arkeologjisë në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:

Butrint

- Vijimi i rilevimit topografik të mureve rrithuese me Laser Scanner dhe realizimi i planimetrike, prerjeve dhe prospekteve të integruara në shkallë 1:50;
- Rilevimi fotogrametrik 1:50 i sipërfaqeve arkitektonike;
- Dokumentim analistik-pastrim sipërfaqësor, fotografim dhe rilevim topografik të detajeve i strukturave rrith Portës së Liqenit dhe rrith kishës në Akropol;
- Hapja e 2 sondazheve me përmasa të kufizuara në segmentin e murit rrithues midis gjimnazit dhe Portës me Kulla (towergate) për të verifikuar praninë eventuale të stratigrafisë, që do të ndihmonte me elementet e nevojshëm për datimin.

Foinike

- Përdorimi i skrepit me qëllim pastrimin e dherave dhe spostimin e tyre nga gërmimet në kuadër të projektit.

I. Gërmime

- Sondazhe dhe kërkime në sektorin e agorasë helenistike dhe bazilikës paleokristiane (A23);
- Sondazhe dhe kërkime në monumentin e periudhes romane, në jug të agorasë heleniske(A11);
- Gërmime në pjesën lindore të kodrës(A5);
- Kërkime në banjo romake(A20);
- Vazhdimi i gërmimeve në "Banesa me suva" (C4).

II. Restaurimi i strukturave të gërmuara dhe valorizimi i sitit

III. Survejimi i territorit

2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2018.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR
KULTURËS
PËRMËSHIMTIRË

SEKRETARIKA

RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: +355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al